

Bardhyl MAHMUTI & Ramdan AVDIU

**ROLI I GRUPIT DIPLOMATIK NË LEGJITIMIMIN E
LUFTËS ÇLIRIMTARE TË UÇK-së**

Abstrakt:

Shpërthimi i luftërave të armatosura gjatë procesit të shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë krijoi kontekstin e ri historik, që imponoi rishikimin e kërkesave politike dhe të mjeteve që duhej përdorur për realizimin e tyre. Derisa shumica e forcave politike që vepronin në viset shqiptare, që ishin nën Jugosllavi, predikonin zgjidhjen e çështjes sonë kombëtare nëpërmjet mjeteve demokratiko-paqësore, LPK-ja e konsideronte luftën e armatosur si të pashmangshme¹. Prandaj filloi angazhimin serioz për t'u përgatitur në këtë drejtim. Qysh në hapat e parë ka pasur përpjekje serioze të drejtuesve të LPK-së, për të bashkërenduar dhe koordinuar veprimet me partitë politike në Kosovë, por këto përpjekje nuk kanë rezultuar suksesshëm. Në takimet që kemi pasur atëbotë me kryetarin e LDK-së z. Rugova insistonte se deviza e angazhimit duhet të jetë “pa demokraci nuk ka liri”, kurse ne insistonim se nuk jemi larg, vetëm vendi duhet t’ju ndërrohet fjalëve dhe duhet të udhëhiqemi nga deviza “pa liri nuk ka demokraci”!

Fjalët kyçe: *Kosova, LPK-ja, LDK-ja, UÇK-ja.*

¹ Programi dhe Statuti i LPK-së, kreu III 15 - Prishtinë 1993.

LPK-ja e krijoj UÇK-në, ndërsa platforma e saj politike² për bashkimin e të gjitha forcave politike dhe shoqërore shqiptare, pa dallime klasore, ideologjike, fetare apo krahinore për çlirimin e vendit, u shndërrua në platformë politike të UÇK-së. Për dallim nga periudhat e përparshme të rezistencës, kur si pasojë e arrestimeve dhe e vrasjeve rezistenca merrte kohë për t'u riorganizuar, Pranvera e madhe '81 vuri në binarë lokomotivën që, pa u ndalur fare, do të shpinte në realizimin e aspiratave tona kombëtare. Gjaku i Jusuf dhe Bardhosh Gërvallës, i Kadri Zekës, Rexhep Malës, Nuhi Berishës, Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut, dhe gjaku i të gjithë të rënëve në përballje me okupatorët, trasuan rrugën drejt lirisë. Rënia e heronjve të lartpërmendur dhe aksionet e armatosura të bashkëveprimtarëve të tyre shënojnë momente të rëndësishme të luftës sonë të armatosur dhe pasqyrojnë pjesën më madhështore në procesin e formimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Prandaj, formimi i UÇK-së duhet të shihet si proces, ku çdo sakrificë ka vendin e vet, ndërsa Mbledhja e Katërt e Përgjithshme e LPK-së, e mbajtur në Prishtinë më 26-27 korrik 1993 (ku ndër të tjera u vendos edhe ndërrimi i emrit nga LPRK në LPK), paraqet një moment kyç në këtë proces, sepse pikërisht në këtë mbledhje u vendos të fillohet me strukturimin e njësiteve të armatosura, që kishin kryer aksione kundër forcave të okupatorit, në një forcë ushtarake, që do të merrte përsipër çlirimin e vendit. Pra, duke përcaktuar si qëllim të vetëm politik çlirimin e vendit nga okupatorët, Lëvizja Popullore e Kosovës ofroi platformën, që mundësonte të liheshin anash dallimet klasore, ideologjike, fetare dhe krahinore dhe të mobilizoheshin të gjitha forcat politike, shoqërore, intelektuale dhe profesionale rreth këtij qëllimi. Përkundër angazhimeve të Lëvizjes Popullore të Kosovës, që përballë okupatorëve të lihen anash dallimet ideologjike ndërmjet forcave politike shqiptare, gjatë gjithë periudhës që i parapriu luftës çlirimtare, madje disa eksponentë edhe sot predikojnë dhe përpiqen në vazhdimësi ta stigmatizojnë lëvizjen çlirimtare si

² Po aty.

lëvizje e ngarkuar me ideologji të majtë marksiste-leniniste.

Që të kuptohet drejt kjo çështje, e shoh të rëndësishme të sqaroj disa aspekte teorike, të cilat lidhen me nocionet në fjalë. Fillimisht po tërheq vëmendjen se dallimi thelbësor ndërmjet doktrinë marksiste-leniniste dhe nacionalizmit si ideologji lidhet me çështjen kombëtare. Përderisa komunistët e të gjitha rrymave e shohin kombin të ndarë në klasa, i japin përparësi luftës së klasës punëtore kundër klasës së borgjezisë dhe predikojnë rreshtimin përkrah proletariatit ndërkombëtar, nacionalizmi përpiqet të fshijë të gjitha dallimet klasore, ideologjike, fetare, krahinore etj., brenda kombit, me qëllim që të dalë unik karshi kombeve të tjera që përpiqen ta rrezikojnë interesin e tij.

Të gjitha aktet normative të LPK-së (programi, statuti dhe shkrimet në “Zërin e Kosovës”) kanë qenë pikërisht në frymë të tejkallimit të dallimeve klasore, ideologjike, fetare dhe krahinore të shqiptarëve dhe për unitet kombëtar. Synimi për t’u bashkuar me shtetin amë në kohën kur Shqipëria udhëhiqej nga komunistët, nuk e bën LPK-në organizatë të orientimit të majtë, siç nuk e bën as të orientimit të djathtë duke ruajtur të njëjtin synim edhe gjatë kohës kur, pas përmbyesjes së regjimit komunist, në pushtet erdhi e djathta. Në kohën kur shqiptarët në Kosovë shtypeshin “djathtas”, “majtas” dhe “në qendër”, ndasitë ideologjike “e djathtë”, “e majtë” dhe “e qendrës” vërtet nuk kishin kurrfarë kuptimi. Aksionet e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës vijnë duke u shtuar, sidomos pas përfundimit të Konferencës në Dejton,³ ku u arrit marrëveshja për përfundimin e luftës në hapësirat e ish-Jugosllavisë⁴. Në këtë Konferencë nuk iu krijua mundësia shqiptarëve që të jenë pjesëmarrës, kurse në marrëveshjen e arritur mes serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve çështja e Kosovës dhe e shqiptarëve që jetonin nën ish-Jugosllavi, mbeti plotësisht e injoruar. Aty dominoi qëndrimi i Millosheviqit se Kosova

³ Marrëveshja në Dayton 14.12.1995, DOC; 126173.pdf (osce.org)

⁴ Le 14 décembre 1995, les Accords de Dayton mettaient fin à la guerre en ex-Yougoslavie (rfi.fr).

është problem i brendshëm i Serbisë.⁵ Qasja që e kishin partitë politike shqiptare duke i vënë të gjitha shpresat e zgjidhjes së drejtë të statusit politik të Kosovës dhe të popullit shqiptar, në ish-Jugosllavi, përmes të ashtuquajturës rezistencë paqësore, nuk kishte dhënë ndonjë rezultat premtues.

Në anën tjetër kërcënimet sistematike serbe ndaj shqiptarëve në kohën kur zhvillohej luftë me përmasa gjenocidale kundër popujve kroat dhe boshnjak te pjesa më e vendosur e kombit, kishte sforcuar bindjen se lufta po mbetet e vetmja rrugë për të shkuar drejt çlirimit. Por te një pjesë tjetër e aktorëve të skenës politike ishte krijuar mëdyshje për të menduar edhe për ndonjë zgjidhje alternative të problemit. Këta të fundit vazhdonin me ngulm të ruanin politikën e mosveprimit dhe të pritjes.

Prandaj aksionet e UÇK-së që paralajmëronin një kurs tjetër më radikal që duhet ndjekur për çlirimin e vendit nuk pëlqeheshin nga ata protagonistë të partive politike sidomos partisë më të madhe, e cila kishte filluar ta ndjejë se po e humbë ndikimin që kishte krijuar nga fillimi i dekadës së fundit të shekullit XX, te shtresat e gjëra të popullsisë. Ata në komunikim me diplomatë të vendeve që vizitonin Kosovën dhe interesoheshin për situatën, aksionet e UÇK-së përpiqeshin të mos i përmendin fare ose edhe të mbanin një qëndrim inferior. Mbase nuk kanë pasur besim se shqiptarët e shtypur deri në palcë do të mund të organizojnë kryengritje të armatosur. Kjo bëri që në sferën ndërkombëtare lehtë të depërtojë dhe të zë vend propaganda e Serbisë që shpërndante në të katër anët e globit, se aksionet e armatosura kundër forcave policore e ushtarake të Serbisë në Kosovë janë terroriste, kurse UÇK-në e paraqisnin si organizatë terroriste, që përmes dhunës synon të marrë pushtet. Varësisht nga rrethanat, koha dhe hapësira, diplomacia serbe përpiqej ta paraqiste UÇK-në, në sy të botës demokratike herë si organizatë ideologjike marksiste që përmes terrorizmit donë të instalojë diktaturën dhe sistemin komunist, herë si organizatë fundamentaliste islamike që ka për qëllim krijimin e një

⁵ Po aty.

entiteti islam në Evropë. Dy tendenca shumë kundërtë.

Në aspektin teorik kjo na ka ndihmuar që në rrafshin ndërkombëtar ta çmontojmë propagandën serbe. Deri në vitin 1998, e vetmja formë e komunikimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës me opinionin publik dhe diplomatik ishin komunikatat që lëshoheshin nga Shtabi Qendror i UÇK-së.

I vetmi subjekt politik që e mbronte dhe arsyetonte aksionet e UÇK-së, e mbështeste financiarisht dhe moralisht ishte LPK-ja, i vetmi medium që e përkrahte luftën e UÇK-së në këtë kohë ishte organi i LPK-së “Zëri i Kosovës”, gazetë kjo që botohej në Zvicër dhe shumë pak ekzemplarë mund të futeshin në Kosovë. Shihej se vetëm kjo formë e komunikimit nuk mjaftonte, prandaj edhe kërkoheshin alternativa. Drejtues dhe pjesëtarë të LPK-së, filluam të animojmë gazetarë të medimeve të njohura në vendet me peshë në arenën ndërkombëtare. Gjatë protestave të shpeshta para selisë së OKB-së, krijojmë kontakte me media.

Shpejt arritëm në cilësinë e LPK-së të organizojmë konferencë për shtyp me gazetarët e akredituar në selinë e OKB-së në Gjenevë, e kërkonim dhe arsyetonim domosdoshmërinë e kthimit të vëmendjes së opinionit ndërkombëtar në Kosovë, ku shqiptarët janë populli më i shtypur jo vetëm në Evropë dhe arsyetonim veprimet e aksionet e UÇK-së. Më 31 janar 1997, në Pestovë bien heronjtë e parë pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Zahir Pajaziti, Hakif Zejnuallahu dhe Edmond Hoxha. Vrasja e komandantit të Shtabit Operativ dhe bashkëlufetarëve të tij u përcoll edhe me një fushatë arrestimesh kundër veprimtarëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjithandej Kosovës. Kjo nuk kishte mbetur pa u vënë re nga mediat dhe diplomacia ndërkombëtare.

Gazeta, dhe agjencitë e mëdha të lajmeve në shtete me ndikim shkruan disa artikuj lidhur me tendencën e redikilazimit të situatës në Kosovë. Me shtimin e aksioneve të armatosura kundër caqeve të pushtesve serbë, shtohet edhe interesimi i të rinjve për t’u bërë pjesë e saj në njërin anë, kurse i diplomacisë, mediave vendore e ndërkombëtare për të pasur më shumë informacion për UÇK-në në

anën tjetër. Pas betejës në Llaushë të Drenicës në fund të nëntorit 1997 dhe pas daljes publike të ushtarëve Mujë Krasniqi, Rexhep Selimi dhe Daut Haradinaj në ceremoninë e varrimit të mësuesit Halit Geci të vrarë nga forcat serbe, filluan të publikohen artikuj në gazeta të ndryshme nga Uashingtoni e deri në Tokio. Karakteristikë e të gjithë këtyre artikujve ishte fryma dominante se duhet ruajtur paqen, se shqiptarët dhe Kosova duhet të kenë një autonomi në kuadër të Serbisë.

Indiferenca e protagonistëve politikë ndaj luftës së armatosur, kualifikimi i aksioneve të UÇK-së si terroriste bëri që Serbia të ndërmarrë sulme ushtarake dhe policore në fshatrat e Drenicës në fund të shkurtit në Likashon e Qirez, kurse në fillim të marsit më 5, 6, dhe 7 mars në Prekaz me një sulm masiv policor e ushtarak mbi familjen Jashari, e cila bëri epope me rezistencë të paparë vetësakrifikuese ku u vranë, komandanti legjendar Adem Jashari, vëllai dhe bashkëluftëtari Hamëz Jashari dhe shumica dërmuese e anëtarëve të familjes së kryefamiljarit Shaban Jasharit. Këto aksione ushtarako-policore serbe e lëvizën nga vendi edhe diplomacinë euroamerikane.

Krimet monstruoze që kryen forcat serbe në Likoshan, Qirez dhe Prekaz, ku u vranë mbi 80 shqiptarë, shumica dërmuese civilë, fëmijë, gra e pleq, zunë vend të rëndësishëm në mediat më prestigjioze botërore. Në këtë kontekst, më 9 mars 1998, në mbledhjen e mbajtur në Londër, Grupi i Kontaktit nxori Deklaratë për Kosovën. Në Deklaratën e Grupit të Kontaktit nuk përkrahej pavarësia e Kosovës, por zgjidhja shihej nëpërmjet realizimit të një autonomie substanciale për Kosovën brenda Federatës së Jugosllavisë (pika 9 e deklaratës). Kjo qasje shënonte një hap më të avancuar në krahasim me qëndrimet e mëparshme, që synonin ruajtjen e *status quo*-së për hir të ruajtjes së paqes. Më 12 mars 1998 Bashkimi Evropian i përvetësoi qëndrimet e Grupit të Kontaktit, ndërkaq më 19 mars dolën me qëndrim të përbashkët për domosdoshmërinë e gjetjes së një zgjidhjeje politike për çështjen e Kosovës. Nën frymë të njëjtë, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara aprovoi Rezolutën 1160, të datës

31 mars 1998⁶. Që të kuptohet domethënia dhe rëndësia e kësaj rezolute duhet të përmenden disa fakte, që lidhen me kontekstin e zhvillimeve dramatike të asaj kohe. Pas krimeve që forcat e armatosura serbe kryen ndaj shqiptarëve gjatë muajve shkurt-mars '98. Në paragrafin tre të kësaj rezolute tekstualisht shkruhej, se: “Këshilli i Sigurimit dënonte përdorimin e tepërt të forcës nga ana e forcave të armatosura, të policisë serbe kundër civilëve dhe manifestuesve paqësorë në Kosovë, si dhe të gjitha aktet terroriste të kryera nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës ose nga çfarëdolloj grupi apo individ tjetër. Në të njëjtën kohë dënohet çfarëdolloj mbështetje e jashtme për aktivitete terroriste në Kosovë, sidomos në formë të burimeve financiare, të armëve apo trajnimeve”.

Përveç mënyrës se si e trajtonin luftën, po përmend edhe një element shumë të rëndësishëm, në pikën 17 të kësaj rezolute, ku Këshilli i Sigurimit e angazhoi Gjykatën Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë “të fillonte grumbullimin e informatave lidhur me aktet e dhunës në Kosovë”. Duke i kualifikuar krimet si “akte të dhunës”, kjo rezolutë përjashtoi ta konsideronte luftën në Kosovë si “konflikt të armatosur”, pra, në të njëjtën cilësi si luftërat në Slloveni, në Kroaci dhe në Bosnjë- Hercegovinë. Mosnjohja e së vërtetës për luftën tonë çlirimtare dhe ndikimi i propagandës aktive serbe në rrafshin diplomatik kishin ndikuar për një perceptimin negativ të luftës sonë çlirimtare dhe në cilësimin e veprimeve të UÇK-së si “akte terroriste”. Mirëpo, gjërat ndryshuan me vendosjen e kontakteve me diplomatët e shteteve me peshë në skenën politike ndërkombëtare. Gjatë këtyre takimeve ne kemi arritur të shpалosim dhe të arsyetojmë platformën, qëllimet, mjetet dhe metodat që përdorte Ushtria Çlirimtare e Kosovës për çlirimin e vendit. Kështu më 16 qershor 1998, për herë të parë realizohet në Gjenevë një takim në mes të përfaqësuesve të deleguar nga UÇK-ja, Bardhyl Mahmuti dhe Ramadan Avdiu me përfaqësues të SHBA-së. Takim ky që i parapriu takimeve 10, përkatësisht 11 ditë më vonë të të njëjtëve përfaqësues të

⁶ Security Council resolution 1160 (1998).

UÇK-së me përfaqësuesit e State Departamentit amerikan, ambasadorët Robert Gellbard, e pastaj edhe takimi në Crans Montana me ambasadorin Richard Hollbrouke, para të të cilëve u shpalo platforma e UÇK-së duke e arsyetuar domosdoshmërinë e revoltës deri në kryengritje të armatosur si e vetmja rrugë e cila nuk ishte provuar nga shqiptarët për t’u çliruar nga dhuna, terrori dhe gjenocidi serb.

Takimin me ambasadorin Robert Gellbard e konsideruam të suksesshëm, sepse në mbrëmje të asaj dite, zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Xhejms Rubin, doli në konferencë për shtyp dhe e konfirmoi takimin që kemi pasur. Për ne ishte i një rëndësie të madhe fakti, se për herë të parë institucionet shtetërore të SHBA-së hodhën poshtë cilësimin “terrorist” që i vishej UÇK-së dhe deklaruan haptas se UÇK-ja duhej të përfshihej në bisedimet për ardhmërinë politike të Kosovës. Kurse takimin e Z. Mahmuti me ambasadorin Hollbrouke e bëri publik vetë ambasadori në një konferencë për shtyp në Crans Montana, duke u deklaruar publikisht për herë të parë se nuk përjashtohet edhe opsioni për pavarësi të Kosovës dhe se mund të ndiqet shembulli i ndarjes së Sllovakisë dhe Çekisë.

Këto takime pasqyrojnë momentet kthesë të luftës sonë diplomatike dhe ishin uverturë për të krijuar komunikim me qeveritë e vendeve anëtare të Quintit. Menjëherë pas këtyre takimeve u realizuan kontakte dhe komunikime me përfaqësues të qeverive të: Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Italisë, Francës, pastaj me zyrtarë të Parlamentit dhe Bashkimit Evropian, qeveritë e Austrisë, Belgjikës, Holandës, Zvicrës, Norvegjisë dhe vendeve të tjera të BE-së.

Komunikimet ishin intensive sa më nuk mund t’i përballonim vetëm dy përfaqësues, prandaj me formimin e Drejtorisë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si dhe pas formimit të Zyrës së UÇK-së në Prishtinë nga Adem Demaçi, mori formë edhe grupi politik e diplomatik për marrëdhënie me jashtë, i cili përbëhej nga: Bardhyl Mahmuti, Ramadan Avdiu, Jashar Salihu, Bilall Sherifi, Agush Buja për Zvicër, Sabri Kiçmari, Mujë Rugova, Rexhë Ibërdemaj në Gjermani, Pleurat Sejdiu në Britani, Nufri Lekaj në

Norvegji, Ibrahim Xhemajli në Danimarkë, Dino Hasanaj në SHBA, e në Francë ndihmë të konsiderueshme grupit i ka dhënë Xhevat Bislimi. Deri në përfundim të luftës, grupi ka realizuar takime të rregullta me diplomatë të St. Departamentit amerikan, me të gjitha qeveritë e vendeve anëtare të BE-së, me mekanizmat e BE-së dhe të NATO-s, me përfaqësues të Parlamentit Evropian, me zyrtarë të OSBE-së dhe të OKB-së.

Po ashtu ka organizuar konferenca shtypi me media në qendrat kryesore evropiane: Londër, Bruksel, Paris, Berlin, Gjenevë, Nju Jork, Vjenë, Romë, Oslo, Tiranë etj. Anëtarët e grupit kanë dhënë me dhjetëra intervista për mediat më prestigjioze në botë dhe kanë apeluar për domosdoshmërinë e mobilizimit ndërkombëtar për të ndëshkuar regjimin gjenocidal të Serbisë. Luftimet e përditshme në Kosovë dhe aktivitetet diplomatike, legjitimuan Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar. Tashmë kishte deklarata publike të zyrtarëve të SHBA-së dhe të shteteve të BE-së se UÇK-ja është ushtri që lufton kundër një ushtrie.

Në anën tjetër Serbia vazhdonte të përdorte forcat e saja ushtarake-policore jo vetëm për të luftuar kundër UÇK-së, por edhe për ushtrimin e krimit të gjenocidit mbi popullatën shqiptare gjithandej Kosovës. Pas luftimeve intensive, angazhimit të grupit politik të UÇK-së për marrëdhënie me jashtë në një anë dhe terrori shtetëror serb mbi popullsinë civile ku deri në shtator 1998, kishin vrarë mbi 2 000 civilë shqiptarë, në anën tjetër, bëri që më 23 shtator 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së të nxjerrë Rezolutën 1199.⁷ Rezoluta 1199 shprehte qartë brengosjen e Këshillit të Sigurimit të OKB-së për “përdorimin e dhunës së tepërt të forcave serbe të sigurisë policore dhe atyre ushtarake jugosllave, të cilat kanë shkaktuar vrasjen e shumë viktimave civile dhe sipas vlerësimeve të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, zhvendosjen e më shumë se 230 mijë personave (...) 50 mijë prej të cilëve kishin mbetur të pastrehë mbi

⁷ Résolutions adoptées par le Conseil de sécurité en 1998 | Conseil de sécurité (un.org).

kokë. Ky realitet bëri që situata të cilësohej si rrezik, që së shpejti mund të ndodhte një katastrofë humanitare. Përveç kësaj, në paragrafin 5 të Rezolutës theksohet se KS i OKB-së “ishte në dijeni për letrën që Prokurori i Gjykatës Penale Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë i kishte drejtuar Grupit të Kontaktit më 7 korrik 1998, ku vlerëson se situata në Kosovë përbën një konflikt të armatosur në kuptimin e termave të mandatit të kësaj gjykate”.

“Përkeqësimi i situatës në Kosovë përbënte rrezik për paqen dhe sigurinë e rajonit” dhe rrjedhimisht, kjo çështje duhej të trajtohej në kuadër të Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Këto aspekte paraqesin një hap të madh në drejtim të trajtimit të Çështjes së Kosovës në të njëjtin nivel siç ishin trajtuar çështjet e tjera në procesin e shpërbërjes së Federatës së Jugosllavisë. Pas aprovimit të Rezolutës 1199 në KS të OKB-së, Drejtoria Politike dhe grupi politik e diplomatik për marrëdhënie me jashtë i UÇK-së, ka qenë i përfshirë në bisedimet për armëpushim në muajin tetor, pastaj për krijimin e grupit negociator për bisedime në prag të Konferencës së Rambujës.

Si përfundim, grupi politik dhe diplomatik i UÇK-së për marrëdhënie me jashtë, mund të themi se ka funksionuar si një ministri e punëve të jashtme deri në përfundimin e luftës. Ai ka një kontribut të jashtëzakonshëm për legjitimimin ndërkombëtar të luftës së drejtë çlirimtare që e ka udhëhequr UÇK-ja, për afirmimin dhe arsyetimin e bazuar të kërkesave politike të UÇK-së dhe popullit të Kosovës, dhe ka arritur të çmontojë propagandën serbe, e cila ka bërë çmos për të justifikuar në sferën ndërkombëtare politikën e saj gjenocidale kundër popullit shqiptar të Kosovës.